



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS

Për Bordin e Drejtorëve

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2004

Prishtinë, 2005

PËRMBAJTJA

FJALA E RASTIT E KRYETARES SË BORDIT

BORDI I DREJTORËVE TË RTK-SË

FJALA E HYRJES E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

HYRJE

SYNIMET PËR VITIN 2004

TELEVIZIONI

STRUKTURA PROGRAMORE E TELEVISIONIT TË KOSOVËS

DHOMA E LAJMEVE

PROGRAMI INFORMATIV

ZGJEDHJET 2004

PROGRAMI I MËNGJESIT

PROGRAMI ARGËTUES DHE MUZIKOR

SPORTI

OPERACIONET TEKNIKE

RADIO KOSOVA DHE RADIO BLUE SKY

PËRMBLEDHJE

RADIO KOSOVA

PROGRAMI INFORMATIV

PROGRAMI KULTUROR-ARTISTIK

PROGRAMI EDUKATIV-ARSIMOR

PROGRAMET E NATËS

DISA NGA PIKAT MË ATRAKTIVE PROGRAMORE NË RADIO KOSOVË

PROGRAMI NË GJUHËT E KOMUNITETEVE NË RK E BS

PROGRAMI NË GJUHËN SERBE

PROGRAMI NË GJUHËN TURKE

PROGRAMI NË GJUHËN BOSHNJAKE

RADIO BLUE SKY

PROGRAMI INFORMATIV

PROGRAMI ARGËTUES-ARTISTIK

DISA NGA PIKAT MË ATRAKTIVE PROGRAMORE NË BLUE SKY

OPERACIONET TEKNIKE TË RADIOS

UEB-FAQJA e RTK-së

ADMINISTRATA

FINANCAT

FJALA E HYRJES E KRYETARES SË BORDIT TË RTK-SË

Të nderuar,

Raporti vjetor në vazhdim për vitin 2004 përshkruan gjendjen financiare të RTK-së, përfshirë raportin e auditorit ndërkombëtar, skemën programore, përparimin e deritashëm të politikave të reja editoriale dhe mandatin e RTK-së.

Që nga fillimi i RTK-së, në vitin 1999, viti 2004 ka qenë viti më sfidues nga të gjithë të tjerët. Tri çështje kryesore të pazgjidhura vazhdojnë të kërcënojnë qëndrueshmërinë e RTK-së, mediumi i vetëm publik në Kosovë: (1) sigurimi i mbështetjes financiare, (2) pasiguria lidhur me shfrytëzimin dhe pronësinë e ndërtesave dhe (3) statusi ligjor i medias publike në bazë të ligjit të ri në proces. Përkundër këtyre çështjeve të pazgjidhura, RTK-ja ka arritur mandatin e vet në pajtim me të gjitha rregulloret aktuale – ndonëse me vështirësi të theksuar.

Po ashtu, edhe përkundër këtyre çështjeve të pazgjidhura, suksese të mëdha janë arritur në: reformat në program, rritjen e përqindjes së transmetimeve në gjuhët e minoriteteve etnike, zhvillimin e hapësirës për dialog midis komuniteteve etnike dhe ofrimin e informimit profesional nga ngjarjet aktuale dhe zhvillimet politike.

Këto të arritura dëshmojnë se vizioni për RTK-në si një medium modern publik për të gjithë kosovarët është vërtetë në rrugë të mbarë.

Ne shikojmë me besim në një të ardhme më të ndritshme dhe më stabile, si dhe në krijimin e mundësisë për t'u angazhuar për zhvillimin e mëtejshëm të resurseve të informimit për të plotësuar nevojat e të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Vjosa Dobruna

Fjala e hyrjes e Drejtorit të Përgjithshëm

Nuk e besoj se stafi ynë mund të ankohet se viti 2004 ka qenë i mërzitshëm. Përkundrazi, besoj se për tërë stafin e Radiotelevizionit të Kosovës ky vit mbase ishte më i ndërlikuari dhe më sfiduesi që nga themelimi i këtij institucioni të rëndësishëm.

Projekti më i rëndësishëm programor i vitit, pa dyshim ishte mbulimi i zgjedhjeve të përgjithshme në Kosovë. Përkundër rrethanave delikate në shoqërinë kosovare, mungesës së përkrahjes sinjifikante financiare dhe stafit të ri, pa asnjë ngurrim mund të thuhet se projekti Zgjedhjet 2004 u realizua me sukses të shkëlqyer. Raportimet për fushatën, si dhe për vetë zgjedhjet shquheshin për nga qasja e qetë, e balancuar dhe profesioniste, si dhe për nga objektiviteti, trajtimi i barabartë dhe gjithëpërfshirës. Mbulimi i këtyre zgjedhjeve, veçanërisht karakterizohet me një avancim domethënës në trajtimin e denjë programor të subjekteve elektorale nga radhët e të gjitha komuniteteve tona etnike. Ne ndjehemi krenarë që RTK-ja i ka dhënë një kontribut të rëndësishëm suksesit të Zgjedhjeve 2004 dhe rrjedhimisht procesit të ndërtimit të institucioneve demokratike dhe demokratizimit të përgjithshëm të shoqërisë kosovare.

Mbulimi i ngjarjeve të marsit ka qenë sfida më e rëndë programore e RTK-së gjatë vitit 2004. Menaxhmenti i RTK-së ka konstatuar se gjatë mbulimit të ngjarjeve të marsit janë shfaqur disa lëshime të caktuara profesionale, të cilat ndonëse të paqëllimshme, janë analizuar me shumë seriozitet nga ana e Menaxhmentit dhe stafit të RTK-së. Duhet përmendur se këto lëshime, ndër të tjera, kanë ndodhur edhe për shkak të rrethanave shumë të ndërlikuara dhe në një situatë të mbylljes së të gjitha burimeve të informimit në 24 orët e para të krizës. Po ashtu, duhet përmendur që pjesa më e madhe e këtyre lëshimeve ka ndodhur në transmetimet e drejtpërdrejta. Sidoqoftë, nga e tërë kjo përvojë, RTK-ja ka nxjerrë mësimet e duhura dhe nga kjo sprovë ka dalë më e fortë dhe më e konsoliduar, gjë që është dëshmuar gjatë performancës në punën e vet të mëtejme si transmetues publik. Ne mbetemi të përkushtuar për trajnime të vazhdueshme të stafit tonë me qëllim të ngritjes së nivelit profesional dhe për kultivimin një gazetarie të paanshme, të pavarur dhe të përgjegjshme.

Dy projekte të reja edhe në gjuhët e komuniteteve etnike "Ulica Sezam" dhe "Magazina e fëmijëve të Ballkanit" kanë qenë hapa të rëndësishëm dhe konkretë të RTK-së në drejtim të përmbushjes së obligimeve të një transmetuesi publik kundruall komuniteteve etnikë që jetojnë në Kosovë. Në këtë kuadër, duhet përmendur edhe përgatitjet për zgjerimin e programit në gjuhën rome nga 20 në 30 minuta në javë. Ndërkaq, nga fillimi i gushtit 2004, Televizioni i Kosovës ka filluar edhe transmetimin e përditshëm të lajmeve të RTK-Radio Blue Sky në gjuhën serbe. Po ashtu, janë bërë të gjitha përgatitjet që, në fillim të vitit 2005, RTK-ja të themelojë korin multi-etnik të fëmijëve, si dhe të startojë me edicionin e rregullt të lajmeve për shurdhmemecë.

Kontrata EBU-RTK, e vazhduar në dhjetor 2004, mbetet e një rëndësie të veçantë për RTK-në, sepse mundëson qasje në programe cilësore me kushte të volitshme, si dhe ofron përkrahje ligjore, teknike dhe trajnime jashtëzakonisht të rëndësishme për ngritjen e mëtutjeshme profesionale të stafit të RTK-së.

Viti 2004 ka qenë viti i parë i plotë i implementimit të parapagimit për shërbimin publik transmetues. Ndonëse shkalla e inkasimit, as përafërsisht nuk i ka mbuluar nevojat për funksionimin dhe zhvillimin e RTK-së, megjithatë mund të thuhet se rezultatet fillestare janë inkurajuese. Pikërisht në këtë fazë shumë delikate të tranzicionit drejt krijimit të vetë-qëndrueshmërisë financiare, jo vetëm që nuk është lejuar rënie e cilësisë dhe sasisë së

programit të prodhuar dhe të emetuar, por përkundrazi është shënuar një zgjerim dhe zhvillim i hovshëm në të gjitha gjuhët dhe zhanret e programeve të RTK-së.

Përkundër të gjitha sprovave, me të cilat u ballafaquam gjatë vitit 2004, RTK-ja arriti që këtë vit, në bazë të sondazheve të pavarura të opinionit, ta përmbyllë si lider në tregun medial të Kosovës, veçanërisht duke konfirmuar pozitën e vet si mediumi më i besuar në vend. Besoj se kjo është një arsye e mjaftuar që tërë stafit të RTK-së t'i shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim më të sinqertë.

Agim Zatriqi

HYRJE

Viti 2004 ka shënuar pesëvjetorin e themelimit të Radiotelevizionit të Kosovës si transmetues i vetëm publik në vend. Në këtë përvjetor, i cili u shënuar në mënyrë të veçantë nga stafi i RTK-së në tetor, Radiotelevizioni i Kosovës u gjend prapë në pozicionin udhëheqës në hapësirën mediale në përgjithësi dhe të mediave elektronike në Kosovë në veçanti. Radiotelevizioni i Kosovës u themelua në vitin 1999, në bazë të një Memorandumi për Mirëkuptim ndërmjet EBU-së (Unioni Evropian i Transmetimeve) dhe OSBE-së dhe i licencuar me Rregulloren 2000/36 të UNMIK-ut mbi themelimin e Radiotelevizionit të Kosovës si transmetues publik. RTK-ja përbëhet nga Televizioni i Kosovës me transmetim terestrial dhe satelitor dhe me dy radio - Radio Kosova dhe Radio Blue Sky.

Viti 2004 ka qenë vit i rëndësishëm për Radiotelevizionin e Kosovës, në aspektin e të arriturave të mëtejme programore dhe zhvillimore, duke u ballafaquar me sfida të mëdha, por duke ruajtur prestigjin, besueshmërinë, shikueshmërinë e Televizionit dhe dëgjueshmërinë e Radiove. Viti 2004 ka qenë një vit zhvillimesh të rëndësishme për shoqërinë kosovare, që kanë vënë në sprovë demokracinë në ndërtim, por edhe mediat kosovare dhe Transmetuesin Publik. RTK-ja ka kaluar me sukses edhe këto sfida, ndonëse (si në rastin e ngjarjeve të njohura të marsit) jo tërësisht pa vështirësi dhe lëshime të caktuara profesionale.

RTK-ja edhe gjatë vitit 2004 ka bërë depërtime të rëndësishme në mesin e auditorit kosovar, me një shikueshmëri dhe dëgjueshmëri të lartë, rezultat i së cilës ka qenë ruajtja e pozicionit prijës në mesin e mediave elektronike dhe në hapësirën mediale përgjithësisht në Kosovë. RTK-ja, si transmetues i vetëm publik në Kosovë, ka vazhduar të promovojë dhe avancojë vlerat e synuara demokratike dhe civile në Kosovë, përmes forcimit të elementeve identifikuese për një transmetues publik: gjithanshmërisë, llojllojshmërisë dhe pavarësisë editoriale. Synimet kryesore të RTK-së për vitin 2004 janë arritur, si ruajtja e pavarësisë editoriale të RTK-së, mbajtja e politikës së paanshme redaktuese, arritjet në planin e zhvillimit cilësor të programit me përmbajtje tipike për një transmetues publik, të natyrës informative, edukative dhe argëtuese.

Radiotelevizioni i Kosovës edhe gjatë vitit 2004 ka rikonfirmuar rolin e vet të pazëvendësueshëm të transmetuesit të pavarur publik të Kosovës dhe ka ridëshmuar rolin e vet kyç në informimin e opinionit kosovar. Ai ka aritur të ruajë vendin e vet si transmetues i respektuar publik në Kosovë dhe në rajon.

TELEVIZIONI

Televizioni i Kosovës edhe gjatë vitit 2004, megjithë sfidat e mëdha programore, financiare dhe ligjore, ka arritur një shkallë mjaft të lartë të përmbushjes së objektivave të tij dhe obligimeve të një transmetuesi publik të Kosovës.

Mbulimi i ngjarjeve të marsit ka qenë sfida më e rëndë programore të Televizionit të Kosovës gjatë vitit 2004, ndërkaq zgjedhjet e përgjithshme të tetorit ka qenë projekti më i rëndësishëm dhe më i ndjeshëm programor.

Menaxhmenti i RTK-së ka konstatuar se gjatë mbulimit të ngjarjeve të marsit, janë shfaqur disa lëshime të caktuara profesionale, të cilat ndonëse të paqëllimshme, janë analizuar me shumë seriozitet nga ana e menaxhmentit. Duhet përmendur se këto lëshime, ndër të tjera, kanë ndodhur, edhe për shkak të rrethanave shumë të ndërlikuara dhe në një situatë të mbylljes së të gjitha burimeve të informimit në 24 orët e para. Po ashtu, duhet përmendur që pjesa më e madhe e këtyre lëshimeve ka ndodhur në transmetime të drejtpërdrejta.

Lidhur me performimin e mediave elektronike në Kosovë, gjatë ngjarjeve të marsit, përfshirë RTK-në, edhe KPM-ja ka publikuar një raport kritik. RTK-ja, ka publikuar në tërësi këtë

raport në Web faqen e vet. Ndërkaq, më vonë janë publikuar edhe dokumentet e menaxhmentit të RTK-së lidhur me mbulimin e ngjarjeve të marsit.

Në mes të dhjetorit 2004, është arritur pajtim-marëveshja midis RTK-së dhe KPM-së, me ç'rast procedura e nisur nga KPM-ja kundër RTK-së është mbyllur. Me këtë, RTK-ja ka marrë një numër obligimesh për vitin 2005. Teksti i plotë i kësaj marrëveshjeje është publikuar në web faqen e RTK-së.

Televizioni i Kosovës, duke pasur parasysh nevojën për ngritjen e cilësisë së punës dhe programit, ka ndërrmarë një varg veprimesh konkrete:

- Në bashkëpunim me sektorin e trajnimeve të EBU-së është hartuar një plan i detajuar i trajnimeve, në radhë të parë për stafin gazetaresk dhe redaktorial të Televizionit të Kosovës.
- Në marrëveshje me OSBE-në, EBU ka propozuar ndërsa Bordi ka emëruar një konsulent ndërkombëtar profesional për Dhomën e Lajmeve
- Ka filluar reforma e Dhomës së Lajmeve, përfshirë këtu profilizimin dhe profesionalizimin e gazetarëve nëpër sektore.
- Janës marrë vendime për përforcimin e Dhomës së Lajmeve me gazetarë dhe redaktorë shtesë, etj.

Ndërkaq, mbulimi i zgjedhjeve të përgjithshme të tetorit, si projekti më i rëndësishëm programor, nga menaxhmenti, Bordi dhe nga të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare është vlerësuar si jashtëzakonisht profesional, i balancuar dhe i paanshëm, duke i ofruar të gjitha subjekteve garuese në zgjedhje pjesëmarrje proporcionale në programin zgjedhor të RTK-së. Duhet theksuar se RTK-ja ka mbuluar zgjedhjet, me të njëjtat kapacitete të stafit si edhe gjatë marsit, dhe për herë të parë me përkrahje fare simbolike financiare. Edhe në këto rrethana, Televizioni i Kosovës ka dëshmuar përkushtimin e vet për një gazetari profesionale dhe të pavarur.

Dy projekte të reja në gjuhët e komuniteteve etnike: "Ulica Sesam" dhe "Magazina e fëmijëve të Ballkanit", kanë qenë hapa të rëndësishëm dhe konkretë të Televizionit të Kosovës në drejtim të përmbushjes së obligimeve të një transmetuesi publik kundruall grupeve etnike që jetojnë në Kosovë. Në këtë kuadër, duhet përmendur edhe përgatitjet për zgjerimin e programit në gjuhën rome, nga 20 në 30 minuta në javë. Ndërkaq, nga 9 gushti, Televizioni i Kosovës ka filluar edhe transmetimin e përditshëm të edicionit të Lajmeve të radios Blue Sky në gjuhën serbe. Po ashtu, janë bërë të gjitha përgatitjet që në fillim të vitit 2005 RTK-ja të themelojë korin multietnik të fëmijëve.

Mjerisht, të gjitha përpjekjet e RTK-së për të siguruar donacione për projektin e titimit të programeve në gjuhët e komuniteteve kanë dështuar. Ky projekt do të mundësonte që një numër i madh i programeve të huaja të titroheshin edhe në gjuhët e komuniteteve etnike. Realizimi i këtij projekti do të ngriste përqindjen e programeve në gjuhët e komuniteteve përmbi obligimet ligjore. Sidoqoftë, RTK-ja do të insistojë që ky projekt të realizohet gjatë vitit 2005.

Kontrata EBU – RTK, e nënshkruar fillimisht në janar të vitit 2003 dhe e vazhduar në dhjetor 2004, mbetet e një rëndësie të veçantë për RTK-në, sepse ka mundësuar qasje në programe cilësore me çmime të ulëta, në përkrahje ligjore, teknike dhe në trajnime jashtëzakonisht të rëndësishme për ngritjen e mëtutjeshme profesionale të stafit të RTK-së.


Megjithë sfidat e shumta gjatë vitit 2004, Televizioni i Kosovës ia ka dalë, sipas hulumtimeve të pavarura të opinionit, të ruajë pozitën e liderit medial në Kosovë, madje në të dy komponentat, në atë të besueshmërisë dhe të shikueshmërisë.

Struktura programore e Televizionit të Kosovës


Duke pasur parasysh misionin e transmetuesit publik, Televizioni i Kosovës ka bërë përpjekje që në skemën e vet programore të prezantoj përmbajtje për të gjitha moshat, gjinitë, grupet shoqërore dhe komunitetet etnike.

Në vazhdim mund të shihet një paraqitje grafike e përqindjes së programeve të Televizionit të Kosovës.


E HËNË




E MARTË




E MËRKURË




E ENJTE




E PREMTE



E SHTUNË



E DIEL



Dhoma e lajmeve:

Gjatë vitit 2004 sektori i lajmeve është ballafaquar me sfida jashtëzakonisht të mëdha profesionale. Intensiteti i zhvillimeve të përgjithshme kosovare ka imponuar një qasje dinamike ndaj punës, një angazhim të plotë të gjitha kapaciteteve humane dhe një përpjekje të vazhdueshme që, në situata të ndryshme, të mbahet e të kulivohet koncepti editorial i paanësisë, i korrekhtësisë dhe shpejtësisë. Si një indikator i cilësisë së punës mund të numërohen hulumtimet e rregullta të besueshmërisë dhe shikueshmërisë tek audienca e Kosovës, që tregojnë trendin e ngritjes së vazhdueshme (Index [Kosova&Gallup](#)). Sipas të gjitha parametrave, edicionet e lajmeve të RTK-së edhe gjatë vitit 2004 kanë vazhduar të jenë bosht i kredibilitetit të lartë të RTK-së.

Në aspektin profesional, sfida kryesore kanë qene mbulimi i ngjarjeve të marsit 2004, ndërkaq projekti më i rëndësishëm programor zgjedhjet e përgjithshme të tetorit. Në rastin e mbulimit të ngjarjeve të marsit, janë shprehur një numër i dobësive dhe problemeve, të cilat mund dhe do të shfrytëzohen për zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit të lajmeve në RTK. Jo vetëm shkaku i sfidave të mëdha në mbulimin e ngjarjeve të marsit, është konstatuar se dhoma e lajmeve vazhdon të ketë nevojë për trajnime adekuate të stafit.

Në rastin e mbulimit të zgjedhjet të përgjithshme të tetorit, është konstatuar se ato janë mbuluar në mënyrë korrekte duke zbatuar norma ligjore dhe normat profesionale. Suksesi i gjithë stafit të dhomës së lajmeve në mbulimin e fushatës zgjedhore është një ndër treguesit se përkushtimi ndaj parimeve editoriale profesionale të RTK-së dhe angazhimi i plotë i stafit është garanci e suksesit.

Një vlerësim përgjithësisht pozitiv i punës së gjithë stafit të lajmeve gjatë vitit 2004, mund të konsistojë edhe në faktin se bëhet fjalë për një ekip relativisht të vogël dhe të ri në moshë, i cili vetëm me një përkushtim të plotë ndaj punës ka mundur që të arrijë synimet

bazike për sektorin e lajmeve të RTK-së. Kultivimi i sensit të punës ekipore dhe i synimit për ngritje konstante të cilësë individuale të punës, puna e përhershme nën presion të jashtëzakonshëm - në një kohë të sfidave më të rënda të mundshme profesionale, tregon për një cilësi të veçantë të punës në lajmet e RTK-së. Edhe korrespondenturat e RTK-së në Tiranë, Tetovë, Preshevë, Ulqin dhe Bruksel kanë dhënë një kontribut të madh në cilësinë dhe përmbajtjen e lajmeve të Televizionit të Kosovës. Duhet të shqyrtohet seriozisht mundësia që korrespondentura në Bruksel të kompletohet edhe me ekip xhirues si dhe që të hapet korrespondentura e RTK-së në SHBA.

Ndërkaq, vlen të theksohet veçanërisht shpërblimi ndërkombëtar "ERNO", në kategorinë e mbulimit më të mirë, për mbulimin e ngjarjeve të marsit në Mitrovicë.

Mund të konstatohet po ashtu se ekziston nevoja për shtimin e stafit të gazetarëve, të profilizimit të tyre të mëtutjeshëm profesional si dhe të avancimit të mëtutjeshëm të praktikave editoriale.

Gjatë vitit 2004, në bashkëpunim me konsulentin profesional ndërkombëtar ka filluar diskutimi i riorganizimit të përgjithshëm në dhomën e lajmeve, duke e nisur kështu procesin e adaptimit të këtij sektorit të punës në kushte të reja organizative, me synim të perfeksionimit të funksionimit të të gjitha segmenteve në prodhimin dhe plasimin e lajmeve. Gjatë vitit 2004, po ashtu, ka filluar diskutimi i nevojës për reforma rrënjësore konceptuale e vizuale të edicioneve të lajmeve.

Programi Informativ

Gjatë vitit të kaluar, 2004, Programi Informativ i Televizionit të Kosovës ka përmbushur në masë të konsiderueshme detyrat programore, të parapara me skemën programore.

Televizioni i Kosovës i ka transmetuar drejtpërdrejt të gjitha seancat plenare të Kuvendit të Kosovës. Janë transmetuar drejtpërdrejt seancat e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara kur janë paraqitur raportet tremujore për gjendjen në Kosovë. Janë transmetuar drejtpërdrejt tubime e akademi përkujtimore apo të rastit, si dhe manifestimet kryesore fetare të religjioneve relevante kosovare. Në termimin javor "Drejtpërdrejt", janë organizuar debate të shumta për çështje të ndryshme politike, shoqërore, me pjesëmarrës të shumtë, vendorë e ndërkombëtarë, analistë, bartës të funksioneve institucionale e partiake, etj.

Në "Intervistën e Javës" kanë qenë pjesëmarrës personalitete të shumta-vendore e ndërkombëtare që nga kreu i institucioneve, i subjeteve politike, i organizatave e organizmave të shumta të jetës shoqërore në Kosovë.

Në emisionin "Pro et contra" mesatarisht janë shtruar e rrahur nga tre tema, me pjesëmarrës të shumtë, të të gjitha palëve, të cilët në emision kanë ballafaquar argumente e kundëragjendime.

"Ekonomia dhe biznesi" i është kushtuar çështjeve ekonomike, zhvillimore, investimeve, papunësisë, privatizimit, inicijativës private e çështjeve të tjera nga ky lëm. Një herë në muaj është transmetuar emisioni i përgatitur nga TV UNMIK "Ekonomia e Re".

"Bujku" ka trajtuar problemet e zhvillimit të agrobiznesi në Kosovë.

Në bashkëpunim më Zyrën Zvicërene në Prishtinë janë transmetuar edhe disa emisione kushtuar investimeve të Zvicrës në Kosovë.

Emisioni "Hapat" i është kushtuar çështjeve të të drejtave të qytetarëve në lëmën timer ndryshëm.

Në kuadër të emisionit "Zëri ynë" janë realizuar shumë emisione, në qytete e vende të shumta të Evropës, kushtuar çështjeve të jetës e punës së bashkëqytetarëve tonë në punë të përkohshme në vende evropiane e vende tjera të botës.

"Medika" u kushtohet çështjeve të shëndetësisë. Nga çasja arsimore- shkollore, emisioni tashmë ka një qasje problemore të shëndetësisë - i kushtohet problemeve, vështirësive, sukseseve dhe sfidave me të cilat përballët shëndetësia kosovare.

Po ashtu, duhet përmendur edhe emisionet "Periskopi" dhe "Fqinjët", që janë bashkëprodhuar me disa televizione të rajonit dhe kanë trajtuar çështje me interes për tërë rajonin.

Gjithsesi, vlen të veçohen transmetimi i drejtpërdrejtë nga Zyra Amerikane në Prishtinë, si dhe nga Uashingtoni i manifestimeve me rastin e 4 Kkorrikut, Ditës së Pavarësisë së SHBA-ve, transmetimi i drejtpërdrejtë i fjalimit vjetor të presidentit amerikan para Kongresit, si dhe transmetimi nga Roma i ceremonisë së nënshkrimit të Kushtetutës evropiane.

Zgjedhjet 2004

Menaxhmenti i RTK- së i kishte bërë më kohë të gjitha përgatitjet programore, teknike, organizative dhe operative për mbulim sa më cilësor, sa më të plotë, objektiv dhe profesional të fushatës parazgjedhore. Gjithsesi, duhet përmendur faktin se, për dallim nga zgjedhjet e mëhershme, kësaj radhe përkrahja financiare për një projekt shumë të komplikuar dhe të kushtueshëm ishte simbolike dhe e vonuar, duke vështirësuar kështu në masë të madhe punën.

Megjithatë, është vlerësim unanim dhe i përgjithshëm; i institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, subjekteve politike, i menaxhmentit të RTK-së se Televizioni i Kosovës e ka përcjellje në mënyrë korrekte, të saktë, objektive e të balancuar fushatën parazgjedhore dhe i ka prezentuar objektivisht aktivitetet parazgjedhore të të gjitha subjekteve politike - të partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur. E veçantë e programit zgjedhor 2004 është edhe organizimi i debateve shtesë në gjuhët e komuniteteve.

Programi i mëngjesit

Programi i mëngjesit në RTK, është një program informativ-argëtues, i përditshëm, me kohëzgjatje 2 orë e 30 minuta që ka ruajtur dhe konsoliduar ndikimin e tij në publik. I dedikohet një auditori të gjerë dhe ka një shikueshmëri shumë të madhe. Është njëri ndër katër emisionet më të shikuara në RTK, sipas sondazheve. Shënon përqindjen më të lartë të shikueshmërisë me 92 për qind në krahasim me konkurentët. Programi ka sjellë edhe në vitin 2004 tek publiku tema të larmishme që i interesojnë kategorive të ndryshme të shoqërisë kosovare duke synuar jo vetëm informimin e saktë, por edhe edukimin e publikut.

Megjithëse kemi pasur probleme të vazhdueshme me stafin, një pjesë e të cilit ka munguar për arsye të ndryshme ia kemi dalë mbanë që mos të humbasim shikueshmërinë në mëngjes. Me materialet ekskluzive që kemi transmetuar dhe risitë që kemi sjellë në program kemi ngjallur mjaft interes tek shikuesit.

Programi Kulturor Artistik, Dokumentar, Arsimit dhe për Fëmijë

Me një strukturë të gjerë përmbajtjesh programore, PKADF, edhe gjatë vitit 2004 i ka realizuar në tërësi përcaktimet programore. Në harkun kohor prej një viti, përmbajtjet programore kulturore artistike, shënuan, afirmuan vlerat kulturore artistike dhe letrare në Kosovë dhe më gjerë, por edhe vunë në pahë improvizimet dhe dështimet në fushat përkatëse të kulturës.

Gjatë vitit 2004 janë xhiruar a transmetuar shfaqje teatrore si: "Pallati i ëndrrave", "Prometheu", "Të mallkuarit", "Derdhja e gjakut", etj. Kemi vazhduar me realizimin e projekteve speciale. Veçojmë programin dyorësh kushtuar dokumentarit kanadez "Hijet e luftës".

Janë shënuar edhe disa depërtime të suksesshme në sferën e Programit dokumentar, qoftë me prodhime vetjake, apo në koproduktion. Këto realizime edhe si format televiziv edhe si përmbajtje televizive, ku më shumë e ku më pak, zgjuan interesim të auditorit dhe bënë që, jo një herë, të kërkohet edhe ritransmetimi i tyre.

Televizioni i Kosovës, në skemën e vet programore ka tashmë edhe një Program të konsoliduar ARSIMOR me përmbajtje programore edukative arsimore. Zgjuan interesim të auditorit veçanërisht emisionet "Artet", "Letërsia", "Ora e botanikës", etj. Janë xhiruar e realizuar disa emisione të ciklit të ri "Drita e blertë", kushtuar trafikut rrugor, e po ashtu kanë vazhduar përgatitjet për emisionin e ri arsimor "Edukata muzikore". Ndërkaq, programet e huazuara të cilësisë së lartë, sidomos ato për arritjet teknologjike dhe botën e kafshëve, po ashtu kanë zgjuar interesim të madh tek auditori.

Sa i takon Programit për fëmijë, mund të jemi të kënaqur me sasinë, e gjithnjë e më shumë edhe me cilësinë e prodhimeve tona në këtë sferë, por jo edhe me hapësirën në skemën programore, e cila gjatë vitit 2004 nuk ishte e mjaftueshme. Që planifikuar, por për shkak të mungesës së kapaciteteve produktionale nuk u realizua, emisioni javor i fëmijëve "Lajmet", të cilin synojmë ta realizojmë në vitin 2005. Padyshim fare, emisioni më atraktiv, prodhim i Televizionit të Kosovës ka qenë kuizi për fëmijë "1,2,3, fillo". Ndërkaq, duhet theksuar startimin shumë të suksesshëm të serialit të famshëm për fëmijë "Rruga Sezami", i cili është sinkronizuar në gjuhën shqipe dhe atë serbe nga Televizioni i Kosovës.

Mbetet që gjatë vitit 2005, për aq sa do të ketë mundësi teknike, të punohet më tutje në ngritjen e cilësisë vizuale të emisioneve arsimore, si dhe në avansimin e debateve kritike mbi gjendjen e kulturës kosovare në përgjithësi.

Programi argëtues dhe muzikor

Programet argëtuese të Televizionit të Kosovës, si edhe në vitet e mëhershme, i kushtojnë një rëndësi të veçantë prodhimit dhe transmetimit të emisioneve të cilësisë së lartë.

Kujdes i veçantë i kushtohet përzgjedhjes muzikore, në mënyrë që ajo të jetë në pajtim me standardet më të larta, dhe atë në të gjitha zhanret. Në këtë kontekst duhet përmendur programet kulminate të muzikës operistike dhe përgjithësisht të muzikës klasike të transmetuara nga Televizioni i Kosovës.

Filharmonia e Vjenës me koncertin e saj tradicional edhe këtë ka qenë e pranishme për audiencën kosovare nëpërmjet programit festiv të Televizionit të Kosovës. Koncerti, tashmë tradicional, "Tung Amerikë", dhe shumë koncerte tjera vendore e ndërkombëtare edhe në vitin 2004, kanë mundur të përcillen nëpërmjet programit të Televizionit të Kosovës.

Ndërkaq një depërtim tepër i rëndësishëm për këtë program është edhe krijimi i Big Bendit të RTK-së dhe performimet e tij. Paraqitja e Big Bendit në programet festive të RTK-së ka qenë një risi dhe një freski në konceptet festive programore.

Edhe në sezonin e vet të tretë, seriali vendor "Familja Moderne", ka vazhduar të jetë programi më i preferuar i audiencës kosovare dhe mbase përmbajtja më e veçantë programore e RTK-së, në krahasim me mediat konkurrenente vendore. Po ashtu, duhet theksuar se Televizioni i Kosovës ka emisione të rregullta dhe mjaft të shikuara humoristike. Në koproduksion me "Vizion plus", nga Shqipëria është realizuar spektakli "Ethet dhe Krasta show", me pjesëmarrje masive të të rinjve nga Kosova dhe ka qenë ndër projektet më të suksesshme argëuese gjatë vitit 2004.

Ndërkaq, emisioni argëtues-debatues "Arena" ka sjellë në frymë të re në kulturën komunikuese dhe debatuese në vend, natyrisht kur është fjala për tema të rëndësishme shoqërore por jopolitike, me të cilat merret ky emision.

Programet e huazuara, në radhë të parë filmat dhe serialet, por edhe programet e ndryshme muzikore, që kanë një hapësirë mjaft të madhe në skemën programore të Televizionit të Kosovës, vazhdojnë të mbeten mburrje e programit argëtues dhe e Televizionit të Kosovës në përgjithësi. Ndërkaq, që të gjitha ngjarjet e mëdha botërore në fushën e artit filmik dhe muzikor, edhe në vitin 2004 janë transmetuar nga Televizioni i Kosovës: Ndarja e çmimit "Oscar", BAFTA, Grammy, Emmy, e shumë të tjera.

Ndërkaq, edhe sivjet Televizioni i Kosovës ka ndarë çmimin tradicional "Drita Gërmiza", për të arriturat në fushën e prezantimit televiziv, si dhe të çmimit "Rudolf Sopi", për kamerën më të minë në zhanrin informativ artistik dhe dokumentar.

Sporti

Programi i sportit ka realizuar orë të tëra të programit sportiv. Ky program është përkujdesur që shikuesve t'i sjellë programin më interesant dhe më cilësor të sportit vendor dhe atij ndërkombëtar.

Programi i sportit është angazhuar që në programin e vet t'i ketë të gjitha ngjarjet më të rëndësishme vendore dhe ndërkombetare. Ngjarjet më të rëndësishme të sportit ndërkombëtar kanë qenë Lojërat Olimpikë Verore (LOV) Athina 2004 dhe Euro 2004.

Risi në programin sportiv të TVK-së ka qenë futja në program e Ligës së Kampionëve dhe Euroligës në basketboll, si dhe është vazhduar me transmetimin e Premierë Ligës angleze dhe me NBA.

Krahas programit të pasur sportiv me transmetime të drejtëpërdrejta, programi i sportit është përkujdesur që në programin e vet të ketë edhe ngjarje sportive nga vendi. Për herë të parë në TVK, është përcjellë në mënyrë krejtësisht ndryshe kampionati evropian i futbollit, EURO 2004, me mysafirë në studio dhe audiencë. Gjithashtu, për herë të parë është shënuar një hap i rëndësishëm interaktiv në raport me audiencën duke emetuar mesazhet elektronike të shikuesve.

Programi i sportit të TVK-së ka përcjellë në mënyrë të veçantë edhe ndeshjet e kombëtares së Shqipërisë, duke i paraprirë kësaj ngjarjeje me emision special në studio, me mysafirë të ftuar dhe audiencë. Në kuadër të emisioneve të përjavshme, redaksia e sportit ka përgatitur edhe emisione 30-minutëshe nga sporti ndërkombëtar (Premier liga, Liga e Kampionëve dhe nga basketbolli amerikan, NBA Action).

Në vazhdim po ju paraqesim ngjarjet e sportit të cilat TVK i ka mbuluar gjatë periudhës janar-dhjetor 2004:

Sporti vendor

- Atletikë Maratona ndërkombetare "Prishtina 2004"
- Futboll Finalja e kupës së Kosovës, Turneu i futbollit "Burim Hatipi"
- Basketboll Ndeshjet kampionale dhe të kupës
- Hendboll Ndeshjet kampionale, finalja e kupës
- Volejball Ndeshjet kampionale dhe finalet e kupës
- Tenis vendor Dielli OPEN
- Boks vendor Turneu i boksit "Adem Jashari", meçe ndërkombëtare të boksierëve kosovarë
- Futboll i vogël Turne të organizuar në Prishtinë

Sporti ndërkombëtar

- LOV Athina 2004
- EURO 2004 Kampionati evropian i futbollit
- Futboll Ndeshjet e kombëtares së Shqipërisë.
- Futboll Liga e Kampionëve
- Futboll Kup UEFA
- Atletikë Liga e artë
- NBA Basketbolli amerikan
- Euroliga Basketbolli evropian
- Futboll Premier-liga angleze - ndeshjet kampionale
- Boks Luan Krasniqi
- Boks Meçe të tjera kulminate të boksit profesionist

OPERACIONET TEKNIKE

Ajo që vlen të përmendet gjatë vitit 2004, është ngritja e cilësisë dhe e sasisë së prodhimit, transmetimi i programit 24 orësh, avancimin e komponentës vizuale, avancimi i njësimit të dizajnit grafik, skenografisë dhe audio njësimit.

Gjatë vitit 2004 janë kryer mbi 160 transmetime të drejpërdrejta nga ngjarje të ndryshme informative, kulturore, sportive, argëtuese, etj. Transmetimet në rrjetin tokësor janë kryer nga të gjitha pikat e mundshme në Kosovë, duke i përdorur 2 linka tokësorë mobilë dhe pjesën e lidhjes mikrovalore fikse Golesh-Prishtinë. Gjithashtu për nevoja programore janë bërë koordinime programore dhe teknike për transmetime dhe xhirime multilaterale dhe unilaterale nga vende dhe ngjarje të ndryshme, si p.sh. Këshilli i Sigurimit, OKB-ja, BE-ja, insitucionet evropiane, Tribunali i Hagës, etj, si dhe transmetime të reporterëve dhe të korrespondentëve tanë nga Nju-Jorku, Brukseli, Haga, Berlini, Lucerni, Roma, etj.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2004, në koordinim me EBU-në dhe qendrat e tjera televizive, për nevojat e këmbimit të lajmeve në rrjetin e EBU-së janë kryer më shumë se 300 transmetime multi dhe unilaterale. Gjithashtu, me kërkesë të TV qendrave anëtare të EBU-së dhe TV qendrave të tjera botërore, kemi ofruar shërbime tekniko-teknologjike të cilat kenë sjellë të hyra të konsiderueshme.

Puna e mirëfilltë dhe ekipore e njësimit të disenjit grafik ka ndikuar që gjatë vitit 2004, RTK-ja ta përmirësojë pamjen vizuale. Dëshmi për këtë janë promot e emisioneve, freskimi i të gjitha grafikave të emisioneve ekzistuese si dhe grafikat për emisione të reja, si p.sh. Etnika, Omnibusi, RTK Live, RTK - Unplugged, RTK- Koktej, Zgjedhjet 2004, etj.

Me disenj të ri dhe modern janë realizuar një numër i madh skenografishë në të dy studiot e RTK-së si dhe skenografia për xhirime dhe transmetime jashtë studios. Vlejnë të veçohen skenografitë: Fama, Omnibusi, Kampionati Evropian - 2004, Zgjedhjet 2004, Zgjedhjet Presidenciale në SHBA, Arena, etj., si dhe skenografitë e realizuara jashtë studiove të RTK-së: Koncerti i Eda Zarit, Tung Amerikë, Zambaku i Prizrenit, Kosovarja këndon, Koncerti në nder të 5-vetorit të RTK-së, Zogjët këndojnë, Programi i Vitit të Ri 2005, etj.

Kontribut të veçantë ka dhënë ekipi realizues profesional i RTK-së, (realizatorët, kameramanët, montazherët, etj.), si në studio ashtu edhe me autoreportazh. Suksesi i realizimeve të projekteve të ndryshme nga ky staf më së miri u dëshmuar me ftesën që i bëri RTSH (Radio Televizioni Shqiptar) për realizimin e ndeshjes futbolistike të vlefshme për eliminatorë të Kampionatit Botëror: Shqipëri – Danimarkë dhe Shqipëri - Ukrainë.

Me **angazhimin** e një audio mikseri me përvojë dhe përgatitje adekuate, në periudhën e katërt të vitit të kaluar u ngrit dukshëm cilësia e audio sinjalit. Për një kohë të shkurtër, në studion e audio sinkronizimeve, me investime minimale, u mundësuan incizimet në 24 kanale digjitale të të gjitha zhanreve muzikore. Në këtë periudhë, janë kryer sinkronizimet e serialeve për fëmijë, si: Teletabisët, Rruga Sezami, programe të ndryshme arsimore, audio incizime për programet festive të RTK-së, Big Band, Folklori, Ansambli Shota, etj.

Në vazhdim japim pasqyrën tabelare të xhirimeve në të dy studiot dhe në autoreportazh:

PKADF (Programi kulturor , arsimor , dokumentar dhe i filmit)

PËRSHKRIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTALI / ORË
PCR 1 dhe 2 / xhirimet	42.00	48.00	58.00	53.00	62.00	58.00	32.00	44.00	56.00	41.00	39.00	52.00	585.00
PCR 1dhe 2 Drejtperdrejt	0.00	1.00	2.00	11.00	11.00	8.00	9.00	10.00	9.00	11.00	11.00	8.00	91.00
OB VAN /xhirime	0.00	3.00	3.00	0.00	0.00	12.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	18.00
OB VAN/ Drejtperdrejt	0.00	0.00	1.00	0.00	2.00	0.00	0.00	2.00	0.00	0.00	9.00	5.00	19.00

PA (Programi argëtues)

PËRSHKRIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTALI / ORË
PCR 1 dhe 2 / xhirimet	29.00	24.00	39.00	32.00	43.00	32.00	25.00	28.00	36.00	32.00	41.00	68.00	487.00
PCR 1dhe 2 Drejtperdrejt	15.45	30.30	15.00	9.00	9.00	5.00	9.00	1.00	1.00	1.00	4.00	5.00	105.15
OB VAN /xhirime	24.00	39.00	24.00	59.00	51.00	61.00	35.00	9.00	37.00	38.00	38.00	120.00	535.00
OB VAN/ Drejtperdrejt	0.00	0.00	4.00	0.00	0.00	0.00	28.00	27.00	17.00	15.00	16.00	0.00	107.00

PI (Programi informativ)

PËRSHKRIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTALI / ORË
PCR 1 dhe 2 / xhirimet	34.30	34.30	25.00	29.00	36.00	27.00	32.00	37.00	48.00	52.00	36.00	39.00	468.60
PCR 1dhe 2 Drejtperdrejt	22.10	24.00	41.30	10.00	12.00	46.00	25.30	9.00	23.00	56.00	10.00	10.00	289.10
OB VAN /xhirime	2.00	0.00	0.00	14.00	4.00	13.00	17.00	0.00	8.00	48.00	0.00	20.00	126.00
OB VAN/ Drejtperdrejt	24.00	14.00	17.00	37.00	46.00	13.00	5.00	17.00	12.00	44.00	12.00	6.00	247.00

TOTALI (PCR1 , PCR2, OB VAN)

PËRSHKRIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTALI / ORË
PCR 1 dhe 2 / xhirimet	105.00	106.30	122.00	114.00	141.00	117.00	89.00	109.00	140.00	125.00	116.00	159.00	1540.00
PCR 1 dhe 2 Drejt përdrejt	38.00	55.00	59.00	30.00	32.00	59.00	43.00	20.00	33.00	68.00	25.00	23.00	485.00
OB VAN /xhirime	26.00	42.00	27.00	73.00	55.00	86.00	52.00	9.00	45.00	86.00	38.00	140.00	679.00
OB VAN/ Drejt përdrejt	24.00	14.00	22.00	37.00	46.00	13.00	33.00	46.00	29.00	59.00	37.00	11.00	388.00

Pasqyra e shërbimeve të ENG ekipeve dhe montazhave

PKADF (Programi kulturor , arsimor , dokumentar dhe i filmit)

PËRSHKRIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTALI / ORË
ENG EKIPET	476.00	544.00	555.00	552.00	408.00	346.00	280.00	220.00	320.00	348.00	380.00	290.00	1.575.00
MONTAZHAT	459.00	551.00	475.00	510.00	420.00	387.00	310.00	256.00	354.00	367.00	422.00	313.00	1.485.00

PA (Programi argëtues)

PËRSHKRIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTALI / ORË
ENG EKIPIET	151.00	167.00	176.00	157.00	142.00	120.00	102.00	90.00	146.00	142.00	130.00	148.00	494.00
MONTAZHAT	288.00	307.00	339.00	312.00	189.00	153.00	139.00	125.00	177.00	192.00	154.00	389.00	934.00

PI (Programi informativ)

PËRSHKRIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTALI / ORË
ENG EKIPIET	239.00	292.00	372.00	312.00	248.00	228.00	180.00	146.00	380.00	480.00	180.00	164.00	903.00
MONTAZHAT	319.00	325.00	361.00	353.00	278.00	255.00	212.00	186.00	411.00	532.00	210.00	198.00	1.005.00

EDICIONET E PROGRAMEVE INFORMATIVE

PËRSHKRIMI	Janar /Orë të transmetuara	Shkurt/Orë të transmetuara	Mars/Orë të transmetuara	Prill /Orë të transmetuara	Maj/Orë të transmetuara	Qershor/Orë të transmetuara	Korrik /Orë të transmetuara	Gusht/Orë të transmetuara	Shtator/Orë të transmetuara	Tetor/Orë të transmetuara	Nëntor/Orë të transmetuara	Dhjetor/Orë të transmetuara
Programi i mëngjesit	69.00	67.00	71.30	71.00	72.50	71.00	73.00	73.00	71.00	72.50	71.00	72.50
INFO	5.00	4.50	5.10	5.00	5.10	5.00	5.10	5.10	5.00	5.10	5.00	5.10
Lajmet – minoritetet	9.55	9.05	9.55	9.55	9.30	9.55	9.55	9.30	10.45	11.05	9.55	9.55
LAJMET – Qendrore	15.50	14.50	15.50	15.20	15.50	15.20	15.50	15.50	15.20	15.50	15.20	15.50
BLIC	7.50	7.25	8.05	7.50	8.05	7.50	8.05	8.05	7.50	8.05	7.50	8.05
	106.55	102.30	109.50	108.25	110.45	108.25	111.20	111.35	109.15	112.20	108.25	112.10
											TOTALI	333.35

ENG ekipet dhe montazhat

PËRSHKRIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTALI / ORË
ENG EKIPET	1725.00	1624.00	1736.00	1680.00	1736.00	1440.00	1240.00	1240.00	1440.00	1312.00	1736.00	1736.00	19200.00
MONTAZHAT	1210.00	1160.00	1240.00	1392.00	1440.00	1200.00	992.00	992.00	1320.00	1128.00	1392.00	1392.00	15333.00

LAJMET

Totali i shërbimeve ENG ekipeve dhe montazhave (PKADF , PA, PI, LAJMET)

PËRSHKRIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTALI / ORË
ENG EKIPET	2.951.00	2.627.00	2.839.00	2701.00	2534.00	2134.00	1802.00	1696.00	2876.00	3150.00	2426.00	2338.00	23393.00
MONTAZHAT	2.276.00	2.343.00	2.415.00	2567.00	2322.00	1995.00	1653.00	1559.00	2426.00	2819.00	2178.00	3150.00	21909.00

Pasqyra tabelare e njësitit të titrimit

PËRSHKRIMI	Kohëzgjatja / min	JANAR - DHJETOR / EMISSIONE TË TITRUARA	TOTAL / ORË
FILMA	120'	181	374.00
Seriale	45'	420	315.00
Seriale	24'	54	22.00
Dokumentar	50'	111	92.50
Dokumentar	24'	49	20.00
Program arsimor	24'	18	7.20
Program muzikor	30'	2	1.00
PROMO	1'	12	
TOTAL			832.12

Pasqyra tabelare e komentimeve të sportit

PËRSHKRIMI	Periudha	Numri i komentimeve	ORË TË TRANSMETUARA
PREMIER LIGA ANGLEZE	Janar / Dhjetor	170	255.00
KUPA E UEFA-së	Shkurt / Maj	10	15.00
EURO 2004	Qershor / Korrik	64	96.00
LOV 2004	Gusht	13 ditë	78.00
NBA	Janar / Dhjetor	68	76.00
Liga e Kampionëve	Shtator / Dhjetor	24	36.00
Euro liga /Basketboll	Tetor / Dhjetor	10	15.00

Më 01 / 01 / 2004, RTK transmeton drejtpërdrejt koncertin e Filharmonisë së Vjenës,
Më 18 / 01 / 2004, RTK fillon të transmetojë program gjithëditor, 24-orësh,
Më 09/ 02/ 2004, RTK transmeton drejtpërdrejt ndarjen e Çmimit GRAMMY,
Më 15/ 02/ 2004, RTK transmeton drejtpërdrejt ndarjen e Çmimit BAFTA,
Më 29 / 02/ 2004, RTK transmeton drejtpërdrejt ndarjen e Çmimit „OSCAR“,
Më 07 / 03 / 2004, RTK transmeton drejtpërdrejt ndarjen e Çmimit „RUDOLF SOPI “ për kameramanët më të suksesshëm

RADIO KOSOVA DHE RADIO BLUE SKY

PËRMBLEDHJE:

Radio Kosova dhe Radio Blue Sky kanë realizuar me sukses synimet dhe objektivat programore dhe zhvillimore për vitin 2004. Që të dy radiot kanë arritur të ruajnë vendet e tyre prijëse si radio më të besuara dhe ndër më të dëgjuarat në Kosovë. Radio Kosova ka vazhduar të jetë radioja me kredibilitet më të lartë, si dhe duke ndarë vendin e parë për nga dëgjueshmëria në Kosovë, kurse Radio Blue Sky si radio më tërheqëse dhe më e dëgjuar nga gjenerata e re e kosovarëve. Kjo vlen si për pjesën informative, ashtu dhe për atë të programit të të dy radiove. Gjatë vitit është përmbyllur me sukses projekti zviceran për ndihmë radiove të RTK-së, në aspektin material teknik dhe atë të trajnimit programor. Arritje e shënuar ka qenë edhe fillimi i programit në gjuhën e katërt, atë boshnjake në Radio Kosovë, kurse në ndërkohë është bërë konsolidimi i mëtejme programor në të dy radiot, sidomos në programet në gjuhët e komuniteteve etnike.

Radio Blue Sky dhe Radio Kosova kanë vazhduar të kenë redaksi të ndara të lajmeve, ndërkohë që të dy redaksitë e informacionit kanë pasur bashkëpunim intensiv në baza ditore: mbledhje të përbashkët editoriale, shkëmbim të materialeve përmes rrjetit lokal dhe konsultime të rregullta. I përbashkët ka qenë edhe grumbullimi dhe procesimi i lajmeve. Struktura programore e të dy radiove ka mundësuar që çdo gjysëm ore në njërin nga radio-stacionet të ketë edicione informative. Shfrytëzimi i rrjetit të përbashkët të korrespondentëve si në vend ashtu edhe në rajon, ka mundësuar që edicionet informative të RTK-Radiove të jenë më kualitative dhe efikase në mbulimin e ngjarjeve kryesore nga terreni.

Radio Kosova ka vazhduar të mbetet “radio për të gjithë” por me fokusim tek dëgjuesit e moshës mbi 25-vjeç, ndërkohë që Radio Blue Sky ka vazhduar të jetë radioja më atraktive për gjeneratën e re, moshën nën 25-vjeçare, së cilës edhe i dedikohet ajo.

Radio Kosova:

PROGRAMI INFORMATIV:

Ndryshimet në skemën programore të Radio Kosovës janë bërë që nga 6 Janari 2004, që pos emisioneve të tjera të reja, kanë sjellë risi edhe në emisionet informative. Gjatë ditës, janë transmetuar gjithsej 15 edicione lajmesh në një kohëzgjatje prej 130 minutash, përkatësisht 2 orë e 10 minuta. Radio Kosova ka transmetuar tri edicione qendrore informative: “Ngjarje dite” (30 minuta), “Ditari” (30 minuta) dhe “Kronika ditore” (10 minuta), si dhe 12 edicione lajmesh me nga 5 minuta. Në punën e redaksisë së lajmeve janë sjellë risi në ngritjen cilësore të përditësimit të lajmeve, në përmbajtjet tonike të kronikave nga terreni, në dinamizimin e edicioneve qendrore të lajmeve, me përfshirjen e lajmeve më të fundit nga vendi dhe bota, si dhe me kronika radiofonike dhe shfrytëzimin maksimal të korrespondentëve në vend dhe jashtë dhe në profilizimin e gazetarëve në fusha të caktuara.

PROGRAMI KULTUROR-ARTISTIK është pasuruar me forma të reja. Radio Kosova ka një fond të pasur të Radio dramave dhe të Radio skenave, por duke filluar që nga viti 2004 ky fond është pasuruar me realizimin e një sërë dramash të reja, që është bërë në bashkëpunim me brezin e ri të aktorëve kosovarë dhe të redaktorit të redaksisë së programit kulturor dhe dramës.

PROGRAMI EDUKATIV-ARSIMOR. - Krahas emisioneve ekzistuese, në pjesën e parë të vitit 2004, Radio Kosova ka vazhduar me programe edukative arsimore: TË FLASIM DHE TË SHKRUAJMË DREJT GJUHËN TONË. Një rubrikë tjetër me interes ishte ajo e gjuhës angleze me titull: "Mësojmë anglisht me muzikë" emision i huazuar nga BBC që është mirëpritur nga dëgjuesit tanë, dhe që mendoj se duhet të vazhdojë. Në këtë kuadër edhe emisionet 30 minutëshe për fëmijë janë profilizuar dhe për çdo ditë ato kanë tematikë të ndryshme, kurse të dielën ka ngelur Kolovajza e së dieles.

PROGRAMET E NATËS: Gjatë vitit 2004 është bërë profilizimi i mëtejshëm i PROGRAMIT TË NATËS. Kështu pos ditës së shtunë, gjatë vitit 2004 përkatësisht nga qershori Radio Kosova ka sjellë emisione të veçanta të programit të natës të spektrit të gjerë. Nga fundi i vitit, nga skema programore është zëvendësuar emisioni FOKUS me risi nga programi për diasporën, me këshilla dhe materiale të ndryshme me interes për kosovarët që jetojnë jashtë vendit.

Disa nga pikat më atraktive programoren në Radio Kosovë

KRONIKA DITORE

Nga ngjarje politike që janë përcjellë nga Radio Kosova vlejné të përmenden: fillimi i implementimit të standardeve për Kosovën (janar); protestat e mëdha opozitare në Shqipëri (shkurt); Bisedimet teknike kosovare-serbe në Vjenë (mars); protestat e 16 e 17 marsit; transmetimi i sesionit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (prill dhe gusht); vizita të personaliteteve të ndryshme nga bota në Kosovë; fillimi i procesit gjyqësor kundër 3 shqiptarëve në Hagë (nëntor) dhe qëndrimi i Grupit të Kontaktit në Kosovë (dhjetor).

BOTA E KULTURËS

Emisionet javore kulturore "Nga bota e kulturës", "Takim me krijues", dhe "Portat e Natës" kanë pasqyruar ngjarjet kulturore në Kosovë përmes prezantimit dhe bisedave me krijues të lëmenjve të ndryshëm. Nëpër këtë emision kanë kaluar krijues elitorë të kulturës shqiptare në përgjithësi.

STUDIO E HAPUR

Në këtë emision ka pasur mysafirë nga sfera të ndryshme të jetës politike, ekonomike, kulturore e shoqërore ku është debatuar për rrjedhja aktuale në sfera të ndryshme me të ftuar të zgjedhur në studio që nga kryeministri e deri tek ekspertë të ndryshëm në sfera përkatëse.

GRUAJA SOT

E drejta e gruas, aktiviteti i saj në shoqëri, raportet gjinore, raportet prindore dhe aspekte të tjera të pozitës së gruas në përgjithësi në shoqërinë kosovare kanë qenë tema bosht të këtij emisioni javor shumë të popullarizuar të Radio Kosovës.

EMISIONI PËR BASHKATDHETARË

Ka tërhequr vëmendjen e bashkatdhetarëve tanë në botën e jashtme dhe në diasporë duke realizuar çështje konkrete rreth të drejtave dhe problemeve aktuale të qytetarëve tanë në botë, mundësisë së investimeve dhe kthimit për jetë në Kosovë, veprimtarisë së tyre të përgjithshme në Kosovë, etj.

TRANSMETIME TË NGJARJEVE SPORTIVE

Radio Kosova gjatë vitit 2004 ka bërë transmetimin e të gjitha ngjarjeve sportive në vend dhe jashtë me reporterët dhe bashkëpunëtorët e saj në terren. Janë bërë transmetime të drejtpërdrejta të të gjitha ndeshjeve futbollistike nga Kampionati Kosovar i Futbollit. Janë përcjellë drejtpërdrejt edhe ndeshjet e reprezentacionit të Shqipërisë për kampionatin botëror me komentimet e komentatorëve tanë. Të gjitha ngjarjet e mëdha sportive nga vendi dhe nga bota janë përcjellë denjësisht nga Radio Kosova.

ZGJEDHJET 2004

RADIO Kosova ka bërë mbulimin me sukses të zgjedhjeve të përgjithshme në Kosovë. Ajo ka transmetuar emisione debutuese në kuadër të projektit për mbulimin e zgjedhjeve të përgjithshme – 2004, ka ndjekur aktivitetet e partive dhe të subjekteve politike dhe ka ftuar prezantuar kandidatët në mënyrë të barabartë dhe të paanshëm. Një debat zgjedhor i Radios është transmetuar edhe nga Televizioni i Kosovës nga lokalet e Radios.

THJESHT

Emision për të rinj dhe adoloshentë dedikuar jetës dhe veprimtarisë së të rinjve në Kosovë; jetës së tyre në shkollë dhe jashtë saj, reformave arsimore, me debate nga ekspertë dhe studentë dhe me ballafaqime të drejtpërdrejta lidhur me problematikën rinore dhe studentore.

KUIZI I RADIO KOSOVËS

Një tip i emisionit shkollorë me pyetje nga lëmenj të ndrsyëhm ka ngjallur interesim tek të rinjtë, të cilët kanë falënderuar për emisionin për shkak të ofrimit të diturisë nga lëmenj të ndryshëm të diturisë, shkencës dhe kulturës. Emisioni është realizuar me përkrahjen e sponzorëve.

RADIO DRAMA

Krahas shfrytëzimit të një sërë radio dramash që janë ruajtur në arkivin e Radio Kosovës, gjatë vitit janë bërë edhe incizime të një zërë dramash të reja të autorëve kosovarë. Dramat janë realizuar në bashkëpunim me aktorë të gjeneratës së re të Teatrit Kombëtar të Kosovës.

PROGRAMI NË GJUHËT E KOMUNITETEVE NË RK E BS

PROGRAMI NË GJUHËN SERBE: Ka vazhduar programi ditor dyorësh në gjuhën serbe në Radion Blue Sky – duke filluar nga ora 14:00 dhe deri në orën 16:00. Nga gushti 2004, ka filluar transmetimi i lajmeve në gjuhën serbe edhe në Televizionin e Kosovës. Për këtë qëllim janë punësuar dy prezantuese të lajmeve në gjuhën serbe. Po ashtu programi është pasuruar me raportet e korrespondentëve nga pjesë veriore Mitrovicës, nga Graçanica dhe nga rajoni i Gjilanit. Programi në gjuhën serbe është avancuar në përmbajtje dhe cilësi.

PROGRAMI NË GJUHËN TURKE: Programi në gjuhën turke ka vazhduar konsolidimin e mëtejshëm, duke u bërë më atraktiv dhe cilësor, shumë i afërt për komunitetin turk në Kosovë. Programi është përqëndruar në informim në bazë ditore lidhur me ngjarjet në Kosovë dhe sidomos nga jeta e komunitetit turk. Redaksia ka mbajtur një kontakt të ngushtë me dëgjuesit dhe me KFOR-in turk që gjendet në Prizren. Programi turk ka mbetur në terminin e mëparshëm 16:00 – 18:00, për shkak të efektit pozitiv në dëgjueshmërinë e këtij programi nga ana e dëgjuesve të komunitetit turk në Kosovë.

PROGRAMI NË GJUHËN BOSHNIJAKE: Në mars 2004, ka filluar transmetimi në gjuhën e katërt transmetuese, në atë boshnjake. Programi është transmetuar çdo ditë nga ora 12:30 deri në 14:00 dhe për përgatitjen e tij është angazhuar një redaktor dhe një gazetare. Jane shfrytëzuar po ashtu edhe tre korrespondentë nga mese të ndryshme ku jeton komuniteti boshnjak në Kosovë. Programi në gjuhën boshnjake është përqëndruar në informimin ditor nga Kosova, bota dhe sidomos nga komuniteti boshnjak në Kosovë duke përfshirë edhe segmentin kulturor dhe argëtues-muzikor.

RADIO BLUE SKY

Programi informativ: Radio Blue Sky ka vazhduar të transmetojë gjatë ditës 13 edicione lajmesh. Ato janë transmetuar në çdo gjysmë të orës së plotë, kurse që nga 9 gushti ka filluar emetimi i një edicioni të ri informativ pesëminutësh në orën 13.00. Ky edicion çdo ditë transmetohet edhe nga Televizioni i Kosovës. Në këtë kuadër, edicioni ekzistues informativ në gjuhën serbe në orën 14.00, po nga ajo datë emetohet po ashtu në TVK. Në aspektin cilësor është shënuar rritje me një angazhim më të madh të stafit të gazetarëve dhe të redaktorëve dhe me shfrytëzimin maksimal të korrespondentëve të të dy radiove.

Programi argëtues-kulturor: Si radio që u dedikohet të rinjve nën moshën 25-vjeçare, Radio Blue Sky ka ofruar program të pasur dhe të larmishëm muzikor nga zhanre të ndryshme të muzikës më të re në botë dhe tek ne. Janë prezantuar vlerat muzikore përmes emisioneve speciale muzikore, të top listave e të emisioneve të kontaktit. Është ndjekur hapi me produktionet e fundit muzikore dhe kulturore. Në shkurt të vitit 2004 kemi transmetuar drejtpërdrejt manifestimin e ndarjes së çmimeve të MTV-së për Britani "BRITISH AWARDS", në bashkëpunim me Këshillin Britanik/British Council. Në shtator, është emetuar edhe një ngjarje e madhe e MTV-së, me rastin e ndarjes së çmimeve MOBO për muzikë. Edhe kjo ngjarje u realizua në bashkëpunim me Këshillin Britanik/British Council.

Disa nga pikat më atraktive programore në Blue Sky

"TË FLASIM PËR NDRYSHIME"

Vështirësitë, sfidat dhe përpjekjet e institucioneve vendore e ndërkombëtare për të ndryshuar skemën e zhvillimit ekonomik në Kosovë janë shtjelluar në emisionin javor "Të flasim për ndryshime". Gjatë muajit janar 2004 emisioni e ka shtjelluar në mënyrë komplete problematikën e tenderit të telefonisë së dytë mobile në Kosovë, arsyet e mos aplikimit, kontradiktat dhe pasojat.

"BRITISH AWARDS 2004"

Blue Sky, është i vetmi radiostacion në rajon i cili rregullisht transmeton drejtpërdrejt nga Londra ndarjen e çmimeve më të mira për muzikë në Britaninë e Madhe "British Awards". Transmetimi i ceremonisë "British Awards - 2004" është mundësuar nga buxheti i RTK-së.

METROPOL

Sfera e programit argëtues në Radio është plotësuar që nga muaji shkurt me emisionin e përditshëm 90 minutash "Metropol". Në përgjithësi emisioni trajton, me një ngjyrim komik, zhvillimet në kryeqytetin kosovar, por pa u përqendruar vetëm brenda tij. Në emision bëhen njoftime për shërbimet publike, jetën e të rinjve, jetën kulturore, sportive, etj. përmes bisedave me zyrtarë përkatës. Herë-herë, emisioni është realizuar përmes telefonit edhe nga qytetet të tjera të Kosovës. Kjo është bërë edhe nga Tirana.

EUROSONG 2004

Pjesëmarrja e parë e Shqipërisë në festivalin e këngës së lehtë evropiane "Eurosong" është transmetuar drejtpërdrejt në Radion Blue Sky. Që të dy mbrëmjet, gjysmëfinale dhe finale, të mbajtura në muajin maj, janë transmetuar në Blue Sky në një produksion të përbashkët me Televizionin e Kosovës.

FOKUS LETRAR

Në mars ka filluar realizimi i suksesshëm i emisionit javor, Fokus Letrar, me tematikë librin, botimet e reja, aktivitetet e shkrimtarëve, të shtëpive botuese, kritikën për librin, etj.

ZËRI I ARSYES

Me qëllim të dedikimit të një pjese të emisionit për personat me aftësi të kufizuara, Blue Sky prej muajit nëntor ka filluar të realizojë emisionin "Zëri i Arsyës". Emisioni realizohet në bashkëpunim të ngushtë me OJQ-në "Hendikos", ndërsa ka për qëllim të nxisë interesimin e organeve kompetente për kujdes më të madh ndaj kësaj kategorie të shoqërisë.

TË MIRËNJOHURAT

Solistet që kanë bërë emër në muzikë me kultivimin e këngës shqipe me dekada, trajtohen në mënyrë të veçantë në Blue Sky në edicionet speciale. Pikërisht në datën e lindjes, emisioni Vizioni i Gruas u kushtojë ndaras këngëtareve Nexhmije Pagarusha e Shpresa Gashi.

E DREJTA IME

Në kuadër të promovimit tëtributeve të të drejtave të njeriut, Radio Blue Sky realizon emisionin "E drejta ime". Trajtimi dhe realizimi në mënyrë profesionale i çështjes së të drejtave të njeriut i solli autorit të këtij emisioni, Kastriot Hasani, çmimin e vitit nga Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Kosovës.

SPORT

Në kuadër të inkuadrimit të sportit kosovar në familjen e sportit evropian, Radio Blue Sky, ka përcjellë anëtarësimin e Federatës së Hendbollit të Kosovës në Federatën e Hendbollit Evropian, të realizuar në dhjetor 2004.

ZGJEDHJET 2004

Në kuadër të zgjedhjeve ka pasur programe të reja debutuese, edukative dhe informative. Për mbarëvajtjen e këtyre zgjedhjeve dhe objektivitetin e treguar në informimin e popullatës Radio "Blue Sky" ka marrë mirënjohje nga institucionet përkatëse zgjedhore.

RADIO REPORTAZHET

Një nga pikat unike tërheqëse të Radios "Blue Sky" ka qenë transmetimi i radio-reportazheve nga jeta e përditshme e popullatës kosovare. Në kuadër të këtyre radio-reportazheve ka pasur edhe dokumentarë nga sfera të ndryshme të jetës, realizuar nga gazetarët tanë.

HULUMTIMI I DËGJUESHMËRISË

Me vetiniciativë, Redaktorja Përgjegjëse e Informacionit, ka zhvilluar një hulumtim të opinionit mbi dëgjueshmërinë dhe skemën programore në përgjithësi të Radios "Blue Sky". Nga rezultatet e fituara pas analizës së informacioneve të mbledhura janë dhënë rekomandimet për forcimin e "pikave të dobëta" të skemës programore dhe programeve që ofron kjo Radio në përgjithësi, të cilat pas aprovimit nga Menaxhmenti i Radiove, janë në implementim e sipër.

OPERACIONET TEKNIKE TË RADIOS

Sektori i teknikës gjatë vitit 2004 realizoi një numër objektivash të përcaktuara me planin e biznesit për vitin 2004. Gjatë vitit 2004 teknika e RTK-Radio iu përgjigj me sukses kërkesave programore duke realizuar një numër të madhe transmetimesh nga ngjarje të ndryshme kulturore, politike, fetare, sportivem, etj. Është realizuar në tërësi edhe kontrata me SDC-në, projekt i Qeverisë Zvicerane për RTK-Radio. Në kuadër të projektit, është blerë një automakinë dhe janë instaluar pajisjet e nevojshme të autoreportazhes. Instalimin e pajisjeve e ka bërë inxhinieri ynë i cili ka filluar punën në RTK-Radio nga muaji korrik 2004. Autoreportazhi është përdorur për herë të parë në Skënderaj, për incizimin e programit nga festivali i folklorit burimor.

Gjatë vitit 2004, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky kanë realizuar rreth 100 transmetime të drejtpërdrejta. Transmetimet kryesore kanë qenë: Koncerti tradicional i Filarmonisë së Vjenës (1 janar 2004); Transmetimi i British Awards (shkurt 2004); transmetimi i manifestimit të 12 qershorit nga stadiumi i Prishtinës; Festat Bajrami dhe Kërshëndellat, etj. Përveç këtyre transmetimeve, janë realizuar edhe emisione të drejtpërdrejta me autoreportazhë, si në emisionin Metropol të Radios Blue Sky, programi i Vitit të Ri, etj.

WEB-FAQJA e RTK-së **www.rtklive.com**

Gjatë vitit 2004, web-faqja e RTK-së ka pasur një rritje të konsiderueshme të frekuentimit. Pos rritjet së cilësisë së shërbimeve dhe dendësisë së përditësimit, në këtë rritje ka ndikuar shumë edhe stabiliteti e funksionaliteti i web-faqes. Vlen të përmendet fakti që gjatë evenimenteve të rëndësisë së lartë si festave të ndryshme, Eurovizionit, ndeshjeve të kombëtares, ngjarjeve të marsit dhe ngjarjeve tjera, web-faqja e RTK-së ka qenë stabile. Madje në shumicën e rasteve edhe e vetmja e këtij lloji, që ka shërbyer informacione pandërprerë. Sipas terminologjisë profesionale, web-faqja e RTK-së ka qenë 99.98% të kohës ONLINE.

Aktualisht roli i web-faqes së RTK-së është i shumëfishtë. Ajo jo vetëm që pasqyron RTK-në në mediumin e internetit, por, njëkohësisht plotëson rolin e saj të transmetuesit publik. Pos lajmeve ditore me tekst, të cilat azhurohen gjatë tërë ditës, web-faqja ka edhe sektorin e video-lajmeve. Vizitorët mund t'i shikojnë me video-sinjal këto edicione:

- Edicionin e lajmeve të mëngjesit
- Edicionin e lajmeve "Info"
- Edicionin qëndror të lajmeve të orës 19:30

Si dhe edicionet e lajmeve në gjuhën e minoriteteve:

- Vesti (në gjuhën serbe)
- Haber (në gjuhën turke)
- Vijesti (në gjuhën boshnjake)

Të gjitha këto edicione lansohen në web-faqe rreth 10-15 minuta pas përfundimit të emetimit të tyre në televizion. Çdo 24 orë, edicionet e vjetra zëvendësohen me edicionet e ditës aktuale.

Po ashtu, në web-faqe lansohen edhe emisionet javore në gjuhën e minoriteteve:

- Nedeljni Kolaz (në gjuhën serbe)
- Mozaik (në gjuhën turke)
- Mostovi (në gjuhën boshnjake)
- Yekhipe (në gjuhën rome)

Në web-faqe vizitorët mund të shikojnë serialin e RTK-së "Familja Moderne" për të cilin ka një interesim të jashtëzakonshëm. Në raste të transmetimit të emisioneve me rëndësi të veçantë, ato emisione po ashtu lansohen edhe në web-faqe.

Në sektorin e web-faqes për prezentimin e programit të RTK-së, pos skemës programore dhe web-promove rreth risive në program, vizitorët mund të shikojnë edhe informacione të detalizuara rreth të gjitha emisioneve që transmetohen në RTK.

Nga nëntori, faqja u pasurua me shumë rubrika dhe linka të rinj, në funksion të komunikimit më të mirë me vizitorët. Janë shtuar faqet interaktive, si "dhoma të diskutimeve", këshilla mbi bukurinë, këshilla mjekësore, gatojca, horoskopi, etj. Në këtë aspekt, vlen të përmendet interaktiviteti në transmetimin e teksteve të porosive dhe të e-mejlave gjatë transmetimeve të ngjarjeve sportive, etj.

Pjesë e rëndësishme e web-faqes janë edhe faqet kushtuar RTK-së. Këtu pos informacioneve të përgjithshme mbi transmetuesit publik, frekuencave, historisë së shkurtër, stafit e audiencës, publikohen edhe dokumentet zyrtare të RTK-së. Kjo faqe është pasqyrë e transparencës, ku vizitorët kanë qasje në publikimet e RTK-së si raportet vjetore, deklarat

speciale në lidhje me ngjarjet e ndryshme, raportet e auditimit, por edhe shpalljet e ndryshme si tenderët, konkurset etj. Gjithë ky material gjendet në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht. Stafi teknik i web-faqes është përforduar edhe me një web-disenjer shtesë duke rritur numrin e punëtorëve në gjithsej 3. Me këtë është rritur dukshëm efikasiteti i njësisë për zhvillimin e web-faqes si dhe cilësia në punë.

Vizitat

Prej rreth 10.000 vizitorëve në ditë, sa ka pasur gjatë vitit të kaluar, numri mesatar i vizitorëve gjatë vitit 2004 është rritur në 14.000.

Në bazë vjetore, numri i përgjithshëm i vizitorëve arrin në 3.849.671 vizitorë, apo rreth 321.000 vizitorë në muaj. Në grafikon mund të shihni një rritje të vazhdueshme të qasjeve në ueb-sajtin e RTK-së.




Fig.1 – Grafikoni i vizitorëve në baza mujore

Faqet e shikuara

Mesatarisht në web-faqen e RTK-së shfletohen 1.800.000 faqe në muaj. Totalisht gjatë vitit 2004 janë shfletuar 21.312.815 faqe.




Fig. 2 – Grafikoni i faqeve të shikuara në baza mujore

Orët e frekuentimit

Web-faqja e RTK-së vizitohet gjatë periudhave të ndryshme kohore brenda ditës. Intensiteti më i madh është rreth mesditës, por numri i vizitave nuk është shumë më i vogël edhe gjatë orëve të natës (Shih grafikonin 6):




Fig. 6 – Orët më të frekuentuara

FAQJA E INTERNETIT NË BLUE SKY E RADIO KOSOVË

Në kuadër të ofrimit sa më të shpejtë të informacioneve, edhe gjatë vitit 2004 është punuar edhe në web-faqen e internetit të Radio Kosovës dhe Radios Blue Sky. Duke filluar që nga 28 nëntori 2004, është lansuar ueb-faqja e ridisenjuar e përbashkët e të dy radiove. Kjo është në pajtim me synimin për të bërë një faqe të përbashkët për tërë RTK-në. Zgjidhjet vizuale të faqes, përmbajtja dhe lehtësia e qasjes, kanë bërë që kjo faqe të jetë, pa dyshim, një ndër web-faqet më tërheqëse të radiove kosovare në përgjithësi. Në këtë faqe janë të angazhuar dy gazetarë të cilët kanë punuar në redaktimin, plasimin dhe freskimin e informacioneve për të dy radiot. Në ndërkohë, ka vazhduar bashkëpunimi i ngushtë mes ekipit të web-faqeve të radiove me atë të Televizionit.

SEKTORI I ADMINISTRATËS DHE RESURSEVE HUMANE

Fillimi i vitit 2004 punën e Shërbimit Administrativ në RTK-TV dhe Radio e karakterizon me funksionalizimin e programit kompjuterik të bazës së shënimeve në resurset humane me të gjitha të dhënat e nevojshme për administratë. Ky program ka ndihmuar në masë të madhe në lehtësimin e kryerjes së punëve administrative dhe mbajtjes së shënimeve në listën e pagave dhe llogaritjes së pagave për të punësuarit me të dhënat e kërkuara ligjore.

Gjithnjë duke u bazuar në Ligjin Themelor të Punës, Shërbimi Administrativ ka zbatuar në praktikë kompletimin dhe freskimin e evidencës për të gjithë të punësuarit, duke përfshirë edhe përshkrimet e detyrave të punës për secilin vend të punës. Duhet theksuar se në shërbimin administrativ të RTK-së punojnë tre punëtorë duke përfshirë këtu edhe Drejtoreshën e Administratës. Ky shërbim gjatë gjithë vitit 2004 ka qenë i angazhuar në fushën e legjislaturës mediale në vend dhe ka mbajtur kontakte të rregullta me shërbimin administrativo-juridik të EBU- së.

Gjatë vitit 2004, në RTK-Televizion kanë qenë 270 dhe në Radio Kosovë dhe Radio Blue Sky gjithsej 116 të punësuar me kontratë njëvjeçare të punës, të cilat kontrata ripërtrihen në bazë të vlerësimeve të punës njëvjeçare.

Përveç, bashkëpunëtorëve në të gjitha sektorët e radiove dhe televizionit ka pasur edhe bashkëpunëtorë të tjerë me kontratë mbi vepër, për projekte të veçanta të RTK-së, si: Orkestri i RTK-së "Big Band", seriali televiziv "Familja moderne", projekti /seriali për fëmijë "Rruga Sezam" dhe një numër kontratash mbi vepër për bashkëpunim programor, qoftë për emisione të veçanta arsimore, kulturore, argëtuese, apo kompani të ndryshme.

Gjatë vitit 2004, duke ju referuar tabelës së prokurimit në Televizion dhe Radio, ka pasur 1054 kërkesa në Televizion dhe 402 në Radio. Prej këtyre, në televizion janë gjithsej 48 kontrata të nënshkruara për shërbime, mallra dhe punë, të cilat u janë nënshtruar procedurave të prokurimit. Zyra e prokurimit ka zbatuar metodat e prokurimit dhe ka përdorur dokumentet standarde e procedurale të ofertimit për mallra, punë dhe shërbime.

Për sa i përket zhvillimit dhe përparimit në ndjekjen e procedurave të prokurimit në RTK, është arritur progres në implemtimin e ligjit në fuqi, gjithnjë duke u nisur nga parimet themelore të prokurimit: konkurrencën më të mirë, çmimin më të ulët për furnizime, kualitetin dhe vlerën më të mirë, besueshmërinë, ekonomitetin (kursimin e parave), etj. Çdo sektor dhe shërbim i RTK-së është familjarizuar me planin dhe strategjinë për shpenzimet e dala nga këta sektorë, gjë që i ka mundësuar zyrës së prokurimit të planifikojë prokurimin me kohë.

Për çdo mall, punë apo shërbim të kërkuar, zyra e prokurimit është njoftuar me kohë në mënyrë që të kishte mundësi të hulumtonte tregun dhe të gjente ofertuesit më të mirë, gjithnjë duke i respektuar afatet e caktuara sipas udhëzimeve të dala nga ORPB-ja, respektivisht Ministria për Ekonomi dhe Financa.

FINANCAT

Të hyrat primare të RTK-se në vitin 2004 kanë qenë nga parapagimi e që përbëjnë afro 60% të të hyrave të gjithëmbarshme të RTK-së. Të hyrat nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës përbëjnë 13% të hyrave të gjithëmbarshme. Të hyrat nga marketingu gjenerojnë 17 % të të hyrave të gjithëmbarshme. Të hyrat nga donatorët përbëjnë 2 % të hyrave të gjithëmbarshme ndërsa të gjitha të hyrat tjera përbëjnë 8% të të hyrave të gjithëmbarshme të RTK-së për vitin 2004.

Në vazhdim do të paraqesim pasqyrën e të hyrave për vitin 2004 si dhe pasqyrën e të hyrave nga viti 2003:

Nr. No.	Përshkrimi Description	Të hyrat gjatë vitit 2003 Income for year 2003	2003 (%)	Të hyrat gjatë vitit 2004 Income for year 2004	2004 (%)	Ndryshimi (2004-2003) Difference (2004-2003)
1	Të hyrat nga BKK Income from BCK	2,000,000.00	29	1,000,000.00	13	(1,000,000.00)
2	Të hyrat nga Parapagimi Income from License fee	1,929,140.00	28	4,800,000.00	60	2,870,860.00
3	Të hyrat nga marketingu Marketing income	1,311,275.06	19	1,387,969.10	17	76,694.04
4	Të hyrat nga AER Income from EAR	750,000.00	11			(750,000.00)
5	Të hyrat nga SDC Income from SDC	410,784.82	6	129,562.00	2	(281,222.82)
6	Rimbursimet Reimbursements	181,858.00	3	164,872.69	2	(16,985.31)
7	Të hyrat vetanake Own source income	171,710.96	2	143,488.46	2	(28,222.50)
8	Të hyrat tjera Other income	173,224.25	2	275,702.72	2	112,478.47

9	Obligimet në emër të kërkesave të painkasuara			77,910.66	1	77,910.66
GJITHSEJ TË HYRA TOTAL INCOME		6,927,993.09	100	7,979,505.63	100	1,051,512.54


Nga pasqyra e mësipërme, mundë të shifet se struktura e të hyrave gjatë vitit 2004 ka ndryshuar dukshëm në raport me strukturën e të hyrave gjatë vitit 2003.

Të hyrat nga Buxheti i Kosovës, në vitin 2004 janë më të ulta për 1,000,000.00€ në raport me vitin 2003 apo më të ulta për 12%.

Të hyrat e kalkuluara nga parapagimi për RTK-në, në vitin 2004 janë më të mëdha për 2,870,860.00€ në raport me të hyrat e kalkuluara në vitin 2003 apo më të mëdha për 33%.

Të hyrat nga donatorët, në vitin 2004 janë më të ulëta për 1,031,222.82€ në raport me vitin 2003 apo më të ulëta për 88.84%.

Në vazhdim do të paraqesim në mënyrë grafike strukturën e të hyrave gjatë vitit 2004 :



Në vazhdim do të paraqesim pasqyrën e shpenzimeve të vitit 2004, shpenzimet e parapara me Planin e Biznesit për vitin 2004, si dhe pasqyrën e shpenzimeve nga viti 2003 :

Nr. No.	Përshkrimi Description	Shpenzimet nga viti 2003 Expenses for year 2003	2003%	Shpenzimet e parapara me Plan të Biznesit për 2004 Forecast expenses by business plan for 2004	Shpenzimet e vitit 2004 Expenses for year 2004	Dif.	%
1	Shpenzimet e Programit	1,484,557.03	21.49	1,882,013.00	1,801,713.60	80,299.40	20.25
2	Furnizimet e zyrës Office supplies	38,207.19	0.55	53,000.00	23,611.31	29,388.69	0.27
3	Kasetat Tapes	75,034.14	1.09	160,000.00	71,368.55	88,631.45	0.80
4	Derivate të naftës Fuel	97,154.70	1.41	95,000.00	107,347.61	-12,347.61	1.21
5	Pagat Salary	2,298,313.24	33.27	2,490,937.60	2,261,618.30	229,319.30	25.42
6	Qeverisja Governance	41,008.00	0.59	50,004.00	35,657.72	14,346.28	0.40
7	5% sigurimi pensional 5% contribution for pensions	66,071.27	0.96	171,000.00	155,775.88	15,224.12	1.75
8	Ndrrimi i Natës Overtime	59,114.66	0.86	69,000.00	32,567.73	36,432.27	0.37
9	Përqindja për marketing Marketing commission	132,725.01	1.92	135,000.00	160,695.37	-25,695.37	1.81
10	Shpenzimet komunale Utilities	328,239.43	4.75	340,000.00	370,630.56	-30,630.56	4.17

11	Auditori i Jashtëm External Auditing	23,000.00	0.33	23,004.00	19,550.00	3,454.00	0.22
12	Amortizimi Depreciation	1,352,504.78	19.58	793,000.00	1,132,764.00	-339,764.00	12.73
13	Sateliti Satellite	397,016.64	5.75	398,000.00	397,016.64	983.36	4.46
14	Trainimi Training	55,015.64	0.8	50,000.00	26,729.06	23,270.94	0.30
15	Renovimi Renovation	52,896.07	0.77	110,000.00	3,961.95	106,038.05	0.04
16	Të tjera Others	193,318.13	2.8	319,755.00	239,627.99	80,127.01	2.69
17	Fushata Mediale	80,503.50	1.17				
18	Provizioni nga parapagimi	133,110.66	1.93		331,200.00	-331,200.00	3.72
19	Shpenzimet e sponsoruara nga Marketingu				538,422.20	-538,422.20	6.05
20	Projekti "Sesame Street"				56,073.23	-56,073.23	0.63
21	Shlyerja e kërkesave nga parapagimi				1,129,140.00	1,129,140.00	- 12.69
GJITHSEJ SHPENZIME TOTAL EXPENSES		6,907,790.09	100	7,139,713.60	8,895,471.70	1,755,758.10	100.00

Parapagimi për RTK-në ka filluar të implementohet nga 01.11.2003, përmes faturave të KEK-ut, që don të thotë se viti 2004 ishte vit eksperimental apo provues për RTK-në në inkasimin e parapagimit.

RTK-ja beson se të hyrat primare, ndonse jo të vetme, do të duhej të jenë nga parapagimi si një nga mënyrat e zakonshme të financimit të transmetuesit publik.

Grupi i ekspertëve ndërkombëtar (Task Force Group) në raportin e vet zyrtar thekson se RTK-ja duhet të aplikojë modelin e financimit të përzier, model ky i domosdoshëm, posaqërisht në

vendet e vogla që nuk mund të përkrahin ekonomikisht një nivel të mjaftueshëm të shumës së parapagimit për transmetuesit publik.

Sidoqoft RTK-ja konsideron se kur inkasimi nga parapagimi do të arrijë shkallën që RTK-së t'i sigurojë të hyra të sigurta dhe të mjaftueshme për funksionim dhe zhvillim të nevojshëm do të mund të zbatoheshin disa kufizime për reklamimin e përgjithshëm në shërbimin terestrial siç ndodh në shumë vende.

DONATORËT

RTK-ja është mirnjohëse për përkrahjen e rëndësishme të cilën edhe gjatë vitit 2004 ia ka dhënë Agjencioni Zvicëran për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC).

Që nga data 01.01.2002 RTK-ja menaxhohet nga Menaxhmenti vendor. Të gjithë donatorëve që RTK-në e kanë ndihmuar që nga atëher e gjer më sot në mënyrë të rregullt dhe në afatë u janë dërguar Raportet financiare dhe spjegimet mbi mjetet e shpenzuara. E gjithë kjo ka patur për rezultat që RTK edhe më tutje të ketë mardhënje të mira dhe të ketë kontakte të shpeshta me ish donatorët e sajë, të cilët edhe në të ardhmen shpresohet që të jenë donatorë potencial.

BILANCI I GJENDJES DHE I SUKSESIT PËR VITIN 2004


Plani i Biznesit për vitin 2004 është miratuar nga Bordi i Drejtorëve të RTK-së në Janar të vitit 2004 dhe u është prezentuar donatorëve. Shpenzimet në vitin 2004 kanë qenë më të vogla se shpenzimet e lejuara me Planin e Biznesit për vitin 2004. Mirëpo shpenzimet e pa parapara me Planin e Biznesit për vitin 2004 si janë, kërkesat e painkasuara nga parapagimi si dhe shpenzimet e amortizimit kanë ndikuar që në Bilancin e Suksesit të RTK-së të tregohet deficiti.

Vlera e kërkesave të painkasuara nga parapagimi në vitin e parë të zbatimit të kontratës me KEK-un, kap shumën prej 1,129,140.00 €. Shpenzimet e amortizimit me Planin e Biznesit për vitin 2004 kanë qenë të parapara në shumë prej 793,000.00 € ndërsa sipas Standardeve ndërkombtare të kontabilitetit amortizimi duhet të përlllogaritet në vlerën 100% respektivisht në shumën prej 1,132,764.00 €.

RTK-ja ndjek një politikë të kontrollit të kujdesshëm të shpenzimeve dhe synon të ofrojë shërbime që kanë vlerë më të madhe se mjetet e shpenzuara.

Që nga viti 2002 RTK-ja ka themeluar Zyrën e prokurimit me tre punëtorë profesionalë të punësuar pranë kësajë Zyre, të cilët, në harmoni me rregulloret në fuqi, i mbikqyrin dhe zbatojnë në mënyrë strikte procedurat e prokurimit.

Kontabiliteti udhëhiqet sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe në harmoni me Rregulloret përkatëse që janë në fuqi. Departamenti i financave i RTK-së veç raportit vjetor, përpilon edhe raportet financiare mujore dhe tremujore, të cilat rregullisht analizohen dhe shqyrtohen në Menaxhmentin e RTK-së dhe Bordin e Drejtorëve të RTK-së. Ekzistojnë politikat e shkruara financiare dhe procedurat strikte të kontrollit të shpenzimeve. Asnjë shpenzim nuk mundë të lejohet dhe paguhet pa aprovimin paraprak me shkrim të së paku dy personave të autorizuar.



Pagesat e pagave të punëtorëve të rregullt, ata me kontrata mbi vepër dhe honoraret, bëhen përmes llogarisë bankare ashtu sikurse edhe të gjitha llojet e tjera të shpenzimeve. Pagesat në para të gatshme bëhen vetëm në raste të veçanta dhe të domosdoshme. Pagesat e mëditjeve për udhëtime zyrtare Brenda dhe jashtë vendit bëhen në bazë të Rregullores së shkruar. Me Vendimin e Menaxhmentit të RTK-së është shpallur tenderi për përzgjedhjen e kompanisë ndërkombëtare e cila duhet të e bëjë auditimin e afarizmit financiar dhe të përgjithshëm të RTK-së për vitin 2002, 2003 dhe 2004, sipas standardeve ndërkombëtare. Vetëm pas ardhjes së Menaxhmentit vendor ka filluar zbatimi i politikës së Oditimit financiar të RTK-së nga ana e Kompanive të njohura me licencë ndërkombëtare e të cilat përzgjidhen me tender ndërkombëtar.

Bilanci i suksesit të RTK, sipas gjendjes 31 Dhjetor 2004

Nr.	SHPENZIMET	EURO	TË HYRAT	EURO
1	Shpenzimet e programit	3,505,589.40	Të hyrat nga parapagimi	4,800,000.00

2	Shpenzimet për personel	1,913,771.74	Të hyrat nga BKK	1,000,000.00
3	Kërkesat e painkasuara nga parapagimi	1,129,140.00	Obligimet në emër të kërkesave të painkasuara nga parapagimi	77,910.66
4	Amortizimi	1,127,229.20	Të hyrat nga marketingu	783,919.30
5	Tatimi & Kontributet	491,620.77	Sponsorimet	594,049.80
6	Shpenzimet tjera	385,801.12	Të hyrat tjera	397,142.87
7	Komunalet	342,319.37	Të hyrat nga donatorët	326,483.00
Total Shpenzimet		8,895,472.00	Total të hyrat	7,979,505.63

1. Shpenzimet	8,895,472.00
2. Të hyrat	7,979,505.63
3. Suficiti nga vitet paraprake	61,594.61
4. Deficiti	854,371.76

Bilanci i gjendjes të RTK, me 31 Dhjetor 2004

Nr.	AKTIVI	EURO	PASIVI	EURO
1	Mjetet a gatshme	16,183.50	Kapitali	8,224,083.00
2	Materiali	97,303.03	Obligimet afatshkurtra	754,176.18
3	Kërkesat afatshkurtra	3,420,246.49		
4	Mjetet fikse	4,590,154.40		
5	Deficiti	854,371.76		
Totali i aktivitet		8,978,259.18	Totali i pasivitet	8,978,259.18

Pas mbylljes së shpenzimeve reale dhe atyre të përlogaritura (shpenzimet e kërkesave të painkasuara nga viti 2003 dhe shpenzimeve të amortizimit) si dhe të hyrave reale dhe të hyrave të përlogaritura (të hyrat nga parapagimi dhe obligimet në emër të kërkesave të painkasuara) është përpiluar pasqyra e Bilancit të suksesit të RTK-së për vitin 2004, e paraqitur si më lartë **ku shifet** se RTK për vitin 2004 ka patur deficit në shumë prej 854,371.76€.

Gjatë vitit 2004 RTK i vetëdijshëm për situatën e vështirë financiare me të cilën është ballafaquar, ka bërë kursime dhe redukime në të gjitha sektoret. Kjo ka rezultuar me faktin se RTK gjatë vitit 2004 nukë ka patur probleme me likuiditet (pagesën me kohë të faturave, obligimeve të kontraktuara, pagave, honorareve etj). Mirëpo, burimet e të ardhurave gjatë vitit 2004, kanë qenë të pamjaftueshme që RTK-së t'i sigurojnë edhe ndarjen e mjeteve

rezervë për mbulimin e shpenzimeve të përlogaritura në kontabilitet si janë p.sh. shpenzimet e kërkesave të painkasuara nga viti paraprak dhe shpenzimet e amortizimit.

Në vazhdim do të përshkruajm shkurt shkaqet kryesore që kanë ndikuar në paraqitjen e deficitit në Bilancin e suksesit të RTK-së, për vitin 2004:

- Shlyerja e kërkesave të painkasuara nga parapagimi nga viti 2003 në shumë prej 1,129,140.00€ e të cilat sipas Standardeve ndërkombtare të kontabilitetit e ngarkojn vitin 2004 si shpenzime.
- RTK për vitin 2004 i ka parashtruar kërkesën Ministris për Ekonomi dhe Financa për ndarjen e mjeteve nga Buxheti në shumë prej 2,526,414.00€. Nga shuma e kërkuar RTK-së i janë ndarë mjete nga Buxheti në shumë prej 1,000,000.00€ apo 39% e shumës së kërkuar.
- Viti 2004 është viti i parë që kur RTK ka filluar të e bëjë inkasimin e mjeteve nga parapagimi dhe ky inkasim është dukshëm nën parashikimet me Plan të Biznesit për vitin 2004.
- Shpenzimet e amortizimit me Plan të Biznesit për vitin 2004 janë përlogarit në lartësi prej 50% të vlerës reale gjersa në Bilancin e suksesit për vitin 2004, shpenzimet e amortizimit është dashur të përlogariten dhe paraqiten në vlera reale. Vlera e përlogaritur e shpenzimeve të amortizimit për vitin 2004 kap shumën prej 1,132,764.00€.
- Gjatë vitit 2004 janë mbajtur Zgjedhjet dhe RTK në emër të mbulimit të Zgjedhjeve ka bërë Kërkesë për mbulimin e shpenzimeve në emër të Zgjedhjeve. Shpenzimet e përlogaritura në emër të Zgjedhjeve kapin shumën prej afro 192,000.00€ nga e cila shumë RTK ka marrë shumën prej afro 40,000.00€ apo diku rreth 20% nga shuma e kërkuar. Të gjitha shpenzimet në emër të mbulimit të zgjedhjeve për vitin 2004 RTK ka qenë e detyruar t'i mbulojë vetë, gjë që ka ndodhur për herë të parë.
- Në vitin 2004 ka përfunduar Kontrata me Qeverinë Zvicerane për financimin e Programit në gjuhën Rome. Të gjitha shpenzimet për realizimin e programit në gjuhën rome gjatë vitit 2004 i ka bërë RTK.